



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.877/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Afijete Sada Gillogani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Burim Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë për Kuvend Komunal në Suharekë, Arlind Hajdari, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Suharekë, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.877/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidatit për anëtarë për Kuvend Komunal në Suharekë, Arlind Hajdari, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Suharekë, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.877/2021 të paraqitur nga Arlind Hajdari, nga radhët e Subjektit Politik AAK, me të cilin pretendon se në vendvotimet VV 2430A/01R, VV 2430A/02R, VV 2417A/01R, VV 2417A/02R, VV 2417A/03R, VV 2407A/01R, VV 2407A/02R, VV 2413A/01R, VV 2413A/02R, VV 2413A/03R, VV 2402A/01R, VV 2413A/02R, VV 2413A/03R, VV 2405A/02R, VV 2405A/01R, VV 2413A/02R, VV 2413A/03R, VV 2413A/04R, VV 2418A/01R, VV 2418A/02R, VV 2418A/03R, VV 2418A/04R dhe VV 2206E/03R, ka raste të mospërputhjeve të votave tek subjekti AAK ashtu që ka mungesë të votave për kandidatët e subjektit politik AAK pasi që sipas parashtruesit të apelit nga FRP dalin më shumë vota. Apelit i ka bashkangjitur dy deklarata të votuesve të tij si dëshmi.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Arlind Hajdari, nga radhët e Subjektit Politik AAK, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Suharekës me të cilën kërkon rinumërim të votave në Vendvotimet nr. VV 2430A/01R, VV 2430A/02R, VV 2417A/01R, VV 2417A/02R, VV 2417A/03R, VV 2407A/01R, VV 2407A/02R, VV 2413A/01R, VV 2413A/02R, VV 2413A/03R, VV 2402A/01R, VV 2413A/02R, VV 2413A/03R, VV 2405A/02R, VV 2405A/01R, VV 2413A/02R, VV 2413A/03R, VV 2413A/04R, VV 2418A/01R, VV 2418A/02R, VV 2418A/03R, VV 2418A/04R dhe VV 2206E/03R është i pa bazuar. Për faktin se në të gjitha vendvotimet e lartcekura kandidati në fjalë ka vota, andaj Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel. Ndërsa në vendvotimin numër 2405A/02R për të cilin ka bashkangjitur deklarata të dy votuesve ku pretendon se ka votë, është verifikuar nga të dhënat zyrtare dhe ka rezultuar se i njëjti në atë vendvotim ka gjithsej 5 vota.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.877/2021 më datën 06.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.